



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.11.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 10:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Duke qenë që të gjithë anëtarët janë të pranishëm, përveç zotit Qoku, i cili për arsye shëndetësore e ka të pamundur që jetë në mbledhjen e sotshme.

Po fillojmë mbledhjen plenare të radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 12 nëntor 2020.

Siç jeni në dijeni në këtë rend dite janë përcaktuar 9 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Konkretisht kemi të bëjmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kërkesën e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Më pas është projektvendimi “Për kërkesën e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, përgatitur sërish nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Më pas kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatës e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Më pas kemi shqyrtimin e projektvendimit "Për përfundimin e procedurës së verifikimit për kandidatin për Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për pozicionin Ndhmës Ligjor, të shpallur me Vendimin nr. 498, datë 21.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}", përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

Më tej kemi shqyrtimin e projektvendimit "Për detajimin e pozicioneve aktuale të ndihmësve ligjor nga gjykatat administrative të shkallës së parë pranë gjykatave të apelit", përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

Më pas kemi shqyrtimin e projektvendimeve përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, janë konkretisht 4 projektvendime lidhur me emërimin e përkohshëm të katër kandidatëve në pozicionin e Këshilltarit ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.

Projekt-akti tjetër ka të bëjë me miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore në shpenzime operative, të programit 03310 “Buxheti gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

Më tej kemi zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Dhe së fundi është shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Jemi dakord me rendin e ditës?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, pa humbur kohë le të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit të parë, që për më shumë detaje ia jap fjalën znj. Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në datën 29.10.2020, ka paraqitur “Kërkesë për leje të papaguar për arsye familjare”.

Sipas kësaj kërkesë ajo parashtron se më datë 09.09.2020 ka ardhur në jetë fëmija i saj i parë. Për të mos u zgjatur tek parashtrimi i kërkesës së saj, në mënyrë të përmbledhur, gjyqtarja kërkon leje të papaguar për arsye familjare nisur nga rrethanat faktike dhe ligjore që asaj nuk i lejojnë për të gëzuar lejen e saj të barrë lindjes sipas ligjit “Për sigurimet shoqërore” pasi nuk plotëson kushtet e ligjit në lidhje me sigurimin me të paktën 1 vit.

Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioni ka vlerësuar se, pasi ka marrë edhe informacionin nga dosja personale e gjyqtarit, znj. {...} është emëruar gjyqtare me vendimin nr. 472, datë 20.10.2020 të KLGJ, dhe është caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Kurbin me vendimin nr. 504, datë 27.10.2020. Në datën 28.10.2020 ajo ka bërë betimin para KLGJ-së dhe ka filluar ushtrimin e detyrës. Ditën e nesërme ka paraqitur kërkesën e parashtruar më lart.

Në lidhje me përmbajtjen e legjislacionit, për sa i përket ligjit për Statusin, neni 24 dhe rregullorja e miratuar nga Këshilli, ka përcaktuar edhe në mënyrë të detajuar procedurën që duhet të ndjekë magjistrati kur paraqet kërkesën në një nga këto leje dhe konkretisht për lejen për arsye familjare (nuk po citoj dispozitat, i keni të gjithë parasysh dhe janë edhe tek relacioni), në rastin konkret, lidhur me plotësimin e kushteve sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka paraqitur kërkesën ditën e nesërme që ka filluar ushtrimin e detyrës dhe referuar arsyeve që ajo kërkon këtë leje dhe rrethanave konkrete në të cila ndodhet, nuk është në rastin kur ajo e paraqet këtë kërkesë sipas rregullores, 30 ditë përpara datës kur kërkon të fillojë kjo leje. Sipas kësaj kërkesë, ajo është duke u përkujdesur për fëmijën e saj 8-javësh, në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, dhe kërkon që kjo leje ti jepet menjëherë, pasi çdo ditë që vijon të ushtrojë funksionin e saj e ka të vështirë të realizojë ushqimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijës së mitur.

Kërkesa është paraqitur me shkrim më datë 29.10.2020 dhe leja kërkohet për një periudhë 5-mujore, duke filluar menjëherë nga data që jepet kjo leje.

Së dyti, kërkesa është e shoqëruar me certifikatën familjare dhe personale të fëmijës së mitur.

Leja kërkohet për t'u përkujdesur për një fëmijë të mitur i cili është vetëm 8 javë dhe kjo leje kërkohet që të jepet për 5 muaj, llogaritur që fëmija të mbushë 7 muaj, moment që ai kalon në një fazë tjetër të ushqyerjes edhe në mënyrë suplementare.

Për sa më sipër rezulton se kërkesa e gjyqtares për leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë 5-mujore, duke filluar kjo leje menjëherë, përmbush kriteret e përcaktuara në neni 24 të Ligjit nr. 96/2016 dhe Vendimin nr.72, datë 20.05.2019.

Komisioni vlerëson së në këtë rast, në respektim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të familjes, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Familjes, legjislacionin e marrëdhënieve të punës dhe atë të sigurimeve shoqërore, leja e papaguar, e kërkuar për këtë arsye, nuk mund te refuzohet.

Nuk po ndalem për të cituar dispozitat që keni në relacion që kanë të bëjnë me parashikimet në Kodin e Punës, në Kushtetutë, në Kodin e Familjes, në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

Sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se nëna me fëmijë të mitur, ka të drejtën e garantuar nga Kushtetuta, konventa dhe ligjet e sipërcituara, të qëndrojë dhe përkujdeset për fëmijën e mitur, derisa ai të bëhet 11 muaj. Në rastin konkret, për shkak të rrethana të parashtruara nga vetë magjistratja, ajo nuk plotëson kushtet sipas ligjit për sigurimet shoqërore, thjesht për të përfituar pagesë për leje lindje, por kjo situatë nuk mund t'i heqë asaj të drejtën për të qëndruar pranë fëmijës, derisa ai të bëhet 11 muaj.

Komisioni vlerëson të theksojë së kjo leje nuk mbivendoset apo zëvendësohet me lejen prindërore, pasi është një situatë tërësisht e ndryshme. Leja prindërore, sipas Kodit të Punës, neni 132/1, ka një kusht që të mund të përfitohet, e që është ekzistenca e një viti pune të pandërprerë me të njëjtin punëdhënës dhe merret për aq kohë sa fëmija nuk ka mbushur moshën 6 vjet. Ndërkohë, kur fëmija nuk është më shumë së 11 muaj, referuar legjislacionit të sipërcituar, ky kusht nuk ekziston, pasi është një e drejtë absolute e nënës për t'u kujdesur për fëmijën deri në këtë moshe dhe nuk lidhet me plotësimin e asnjë kushti. Në këtë rast mjafton që nëna ta kërkojë, pasi ligji përcakton shprehimisht se është vetëm nëna ajo që vendosë të punojë apo jo gjatë kësaj periudhe.

Kjo është edhe arsyeja që në këtë rast kjo leje nuk mund të kushtëzohet nga cenimi apo jo i funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën magjistratja, dhe po për këtë arsye nuk u kërkua prej asaj apo vetë Komisioni nuk kërkoi, mendimin me shkrim të

kryetarit të kësaj gjykate. Magjistratja e përfiton këtë drejtë pa asnjë kusht, derisa fëmija të jetë 11 muaj. Në rastin konkret fëmija e znj. {...} është 8 javësh dhe kërkesa për këtë leje me afat 5 muaj, është brenda kësaj moshe.

Për sa më sipër, Komisioni propozon miratimin e kësaj kërkesë.

Përmbajtja e projektvendimit ju është shpërndarë dhe ai propozohet të jetë me këtë përmbajtje:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për dhënie leje të papaguar për arsye familjare për një periudhë 5-mujore duke filluar nga data, që është data e sotme në qoftë se miratohet, 11.11.2020.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Vetëm një korrigjim, data 12 sot.

Jeni dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

Brunilda Kadi: Po! Ndjesë për lapsusin. Data 12.11.2020.

Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro dhe përfitoj nga rasti që të shpreh edhe pendesën time që nuk kam mbajtur të njëjtin qëndrim kur u mor vendimi nr. 270, datë 04.12.2019 në një rast të ngjashëm. Fëmija ishte diçka më i madh, ishte 11 muajsh. Por, që të paktën për një

periudhë edhe më të shkurtër, do mund të kisha votuar pro kërkesës së gjyqtarës {...}, që ishte në rrethana të ngjashme. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Pro dhe për të mos rënë në përsëritje, vlerësoj se nga ana e relatores u sqarua në mënyrë të qartë (*fjala e zonjës Ukperaj ka shkëputje dhe nuk është e mundur të zbardhet*).

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, Këshilli miratoi kërkesën e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar, sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.11.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 10:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Medi Bici** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ilir Toska** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë edhe ky me një kërkesë tjetër për gjyqtaren {...} për dhënie leje të papaguar. Sërish relatore është zonja Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Atëherë, për të qenë praktikë, duke qenë se rastet janë shumë të ngjashme, me rastin që sapo miratuam, bëhet fjalë për një magjistratë tjetër, znj. {...} e cila është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në të njëjtën datë me magjistraten që sapo referova dhe ka filluar ushtrimin e detyrës po në të njëjtën datë. Po në datën 28.10. zonja {...} ka paraqitur kërkesë për leje të papaguar për të njëjtën arsye, me të vetmin ndryshim, që fëmija i saj është i datëlindjes 04.08.2020.

Janë ekzakt të njëjtat argumenta siç u thanë edhe në rastin e parë. Nuk dua të marrën kohën askujt. Relacionin e keni me shkrim. Është i njëjti propozim edhe për gjyqtaren {...}.

Projektvendimin po e lexoj edhe për pjesën e kalimit në votim.

Komisioni propozon që Këshilli të miratojë kërkesën e znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për dhënie leje të papaguar për arsye familjare për një periudhë 5-mujore, duke filluar nga data 12.11.2020.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares znj. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Kadi!

Në qoftë se s'keni diskutime, kalojmë në votimin e propozimit të bërë nga relatorja.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi kërkesën për leje të papaguar për magjistraten znj. {...}, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni përkatës.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.11.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 10:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Medi Bici** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ilir Toska** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do raportohet nga zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 5719 prot., datë 09.11.2020, është regjistruar kërkesa së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me shkresën nr.1134, prot., datë 06.11.2020, nëpërmjet të cilës kërkohet caktimi i një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale nr. 22/50/129 Regj. Themeltar, datë 03.10.2019, kundër një të pandehuri. Kërkesa është bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin

e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sipas preambulës së Vendimit të Këshillit nr.30, rregullat sipas këtij vendimi janë të zbatueshme vetëm “në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave”.

Aktualisht, në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshilli janë përfshirë tetë gjyqtarë, të cilët, për shkak të nevojave emergjente, janë caktuar në pesë gjykata të juridiksionit të përgjithshëm. Ndër të tjerë, në skemën e delegimit është përfshirë edhe gjyqtari {...}, i cili kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në kuadër të të cilës ai dhe familjarët e afërt të tij kanë plotësuar dhe dorëzuar rregullisht formularët e vetëdeklarimit për dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Ndërkohë, asnjë nga gjyqtarët e tjerë të skemës së delegimit nuk ka plotësuar vetedeklarimet si më lart, duke mos plotësuar kështu kushtet shtesë të sigurisë, siç përcakton shkronja “b”, pika 4, e nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për t’u caktuar pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Në kushtet kur në listën e gjyqtarëve të skemës së delegimit është vetëm një gjyqtar që plotëson kriteret dhe kushtet për t’u caktuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, referuar pikës 5, të nenit 13, të Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të Skemës së Delegimit të gjyqtarit”, miratuar me Vendimin e Këshillit nr.22, datë 07.02.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z.{...} për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari i Skemës së Delegimit z. {...} caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}; dhe akuza në ngarkim të tij.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi, konkretisht menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi diskutime? Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.11.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin e procedurës së verifikimit për kandidatin për Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për pozicionin Ndihmës Ligjor, të shpallur me Vendimin nr. 498, datë 21.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}", përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 10:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin e procedurës së verifikimit për kandidatin për Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për pozicionin Ndihmës Ligjor, të shpallur me Vendimin nr. 498, datë 21.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}", përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së verifikimit për kandidatin për Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për pozicionin Ndihmës Ligjor, të shpallur me Vendimin nr. 498, datë 21.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}. Relator është zoti Erjon Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Me Vendimin nr. 399, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

Miratimin e listës emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik

2020-2021, për Këshilltar Ligjor dhe Ndhmës Ligjor, respektivisht sipas Lidhjeve 1 dhe 2, bashkëlidhur vendimit.

Me Vendimin nr. 498, datë 21.10.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, në vitin akademik 2020-2021”, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit për Këshilltarë dhe Ndhmës dhe për zotin {...}, relator jam caktuar unë.

Në datën 28.10.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, në rrugë elektronike, kandidati z. {...} u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, për caktimin e relatorit të kësaj procedure, si dhe për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar apo të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Një ditë më pas, në datën 29.10.2020, në rrugë elektronike, kandidati z. {...} njoftoi se është tërhequr nga pozicioni i Ndhmësit Ligjor, duke paraqitur edhe kërkesën me shkrim pranë Këshillit në të njëjtën datë, të protokolluar pranë Këshillit në të njëjtën datë. Ndërsa me numrin e aktit 3400/4 prot., datë 29.10.2020 i është drejtuar në të njëjtën kohë edhe Shkollës së Magjistraturës, duke na vendosur edhe neve në dijeni, se ka paraqitur kërkesën me objekt: “Heqje dorë nga e drejta për të vijuar si ndihmës ligjor, status i dhënë me vendimin nr. 399, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në këtë shkresë, kandidati ka parashtruar ndër të tjera se: “.....omissis....duke konfirmuar qëndrimin tim për tërheqjen nga pozicioni i ndihmësit ligjor, pra heqjen dorë nga ky kualifikim, për të mundësuar në marrjen pjesë të testimit të radhës që do të organizohet nga institucionet tuaja”.

Me shkresën nr. 908, datë 02.11.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3400/5 prot., datë 03.11.2020, Shkolla e Magjistraturës, na ka përcjellë kërkesën për heqje dorë të paraqitur nga kandidati për ndihmës ligjor z. {...}, duke bërë me dije gjithashtu se

z. {...}, nuk ka nënshkruar as marrëveshjen e regjistrimit për kandidat për këshilltar dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2020-2021.

Në këto kushte, duke vlerësuar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur nga z. {...}, kandidat për Ndihmës Ligjor në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2020-2021, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 399, datë 07.10.2020, si dhe duke mbajtur parasysh shprehjen e vullnetit të tij nëpërmjet kërkesës për t'u tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion, në cilësinë e relatorit të çështjes ia parashtrova rastin Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i cili në mbledhjen e tij të datës 10.11.2020, vendosi pranimin e propozimit dhe përcjelljen e projektvendimit për përfundimin e procedurës për zotin {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi, për t'u miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Muharremaj!

Keni ndonjë diskutim mbi projekt-aktin? Nëse jo, kalojmë në miratimin e tij?

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi përfundimin e procedurës së verifikimit për kandidatin për Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, të shpallur me Vendimin nr. 498, datë 21.10.2020, për kandidatin për Ndihmës Ligjor z. {...}, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.11.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Per detajimin e pozicioneve aktuale të ndihmësve ligjor nga gjykatat administrative të shkallës së parë pranë gjykatave të apelit", përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 10:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Medi Bici | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Per detajimin e pozicioneve aktuale të ndihmësve ligjorë nga gjykatat administrative të shkallës së parë pranë gjykatave të apelit", përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me detajimin dhe transferimin e përkohshëm të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave të apelit.

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin për sa i përket krijimit të Njesisë së Shërbimit Ligjor si pjesë të strukturave të gjykatave të apelit. Kështu, sipas këtij vendimi, gjykatat e apelit do të kenë këtë organikë të parashikuar me ndihmës ligjorë, konkretisht:

- a. Gjkata e Apelit Tiranë – 15 ndihmës ligjorë;
- b. Gjkata e Apelit Durrës – 6 ndihmës ligjorë;
- c. Gjkata e Apelit Gjirokastrë – 3 ndihmës ligjorë;
- d. Gjkata e Apelit Korçë – 3 ndihmës ligjorë;
- e. Gjkata e Apelit Shkodër – 5 ndihmës ligjorë;
- f. Gjkata e Apelit Vlorë - 6 ndihmës ligjorë;
- g. Gjkata Administrative e Apelit – 8 ndihmës ligjorë;

h. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 5 ndihmës ligjorë.

Numri i përcaktuar i ndihmësve ligjorë, për çdo njësi të shërbimit ligjor të ngritur pranë gjykatave, sipas vendimit të mësipërm do të detajohet dhe plotësohet edhe me numrat që do të akordohen me buxhetin e vitit 2021.

Gjithsej, ne kemi për këtë vit 42 punonjës që janë në cilësinë e ndihmësve ligjorë, që janë pjesë integrale e 1593 punonjësve, të miratuar për pushtetin gjyqësor me ligjin e buxhetit për vitin 2020.

Me Vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjorë”, KLGJ ka filluar procedurën për vlerësimin e ndihmësve ligjorë në detyrë në gjykatat administrative, për mundësinë e sistemimit të tyre në gjykatat e apelit.

Aktualisht në gjykatat administrative janë 17 ndihmës ligjorë në organikën faktike, nga të cilët 8 ndihmës ligjorë në Gjykatën e Apelit Administrativ dhe 9 punonjës në gjykatat administrative të shkallës së parë. Punonjësit në detyrë në cilësinë e ndihmësve ligjorë në Gjykatën e Apelit Administrativ do të qëndrojnë brenda gjykatës, pasi KLGJ ka miratuar organikën me 8 punonjës.

Ndihmësit ligjorë të gjykatës administrative të shkallës së parë do të transferohen përkohësisht në Gjykatat e Apelit, që mbulojnë të njëjtin juridiksionin tokësor, sipas tabelës në vijim:

Pozicioni i 2 ndihmësve ligjorë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës do të detajohet në Gjykatën e Apelit Durrës duke e çuar numrin e ndihmësve ligjorë në 3.

Pozicioni i 1 ndihmësi ligjor nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë do të detajohet në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë duke e çuar numrin e ndihmësve ligjorë në 2.

Pozicioni i 1 ndihmësi ligjor nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë do të detajohet në Gjykatën e Apelit Korçë duke e çuar numrin e ndihmësve ligjorë në 2.

Pozicioni i 1 ndihmësi ligjor nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër do të detajohet në Gjykatën e Apelit Shkodër duke e çuar numrin e ndihmësve ligjorë në 2.

Pozicioni i 8 ndihmës ligjorë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë do të detajohet në Gjykatën e Apelit Tiranë duke e çuar numrin e ndihmësve ligjorë në 14.

Pozicioni i 2 ndihmës ligjorë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë do të detajohet në Gjykatën e Apelit Vlorë duke e çuar numrin e ndihmësve ligjorë në 3.

Për sa më sipër, neni 42 i ligjit 98/2016 ka përcaktuar që pranë gjykatave të apelit mund të funksionojë njësia e shërbimit ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë. Në zbatim të Ligjit dhe të Vendimit nr. 424/2020 të KLGJ-së, referuar edhe detajimit për 42 pozicione në strukturën organike të ndihmësit ligjor për vitin 2020, detajohen pozicionet e ndihmësve ligjorë në gjykatat e apelit si edhe transferimi i numrit faktik të punonjësve në detyrë nga gjykatat administrative në pozicionet e reja në gjykatat e apelit sipas tabelës bashkëlidhur projektvendimit.

Pas miratimit të shtesës së numrit të punonjësve të administratës gjyqësore, në ligjin e buxhetit të vitit 2021, do të jetë e mundur detajohen pozicionet për të plotësuar numrin e strukturës së shërbimit ligjor në gjykatat e apelit sipas udhëzimeve/përcaktimeve që ka bërë Vendimi nr. 495, datë 21.10.2020 “Për krijimin e njësive të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”.

Me emërimin e përkohshëm të ndihmësve ligjorë në gjykatat e apelit, KLGJ do të duhet të shprehet me vendim nominal për secilin prej ndihmësve, më poshtë, në një vendimmarrje tjetër.

Në pikën e parë të projekt-aktit, kemi një tabelë e cila pasqyron detajimin dhe gjendjen faktike sa janë ndihmësit ligjorë në gjykatat e apelit dhe sa do bëhen me transferimin e numrave të punonjësve në këto gjykata nga shkallët e para administrative. Në pikën e dytë është parashikuar që efektet juridike të këtij vendimi fillojnë nga data 01.12.2020, datë e cila është optimale dhe krijon mundësi për zbatimin e këtij vendimi, pasi edhe ndihmësit ligjorë do të duhet të dorëzojnë detyrat/dosjet në gjykatat në të cilat aktualisht ushtrojnë funksionet e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pasi të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Shkurtimisht përmbajtja e vendimit e keni si më poshtë:

1. Detajimin e pozicioneve aktuale të ndihmësve ligjorë nga gjykatat administrative të shkallës së parë pranë gjykatave të apelit, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi. 2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë nga data 01.12.2020.

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me projekt-aktin.

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Detajimin e pozicioneve aktuale të ndihmësve ligjorë nga gjykatat administrative të shkallës së parë pranë gjykatave të apelit, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.11.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për:

6.1 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë;

6.2 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë;

6.3 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë;

6.4 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 10:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| 5. <i>Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. ***Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
2. ***Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
3. ***Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
4. ***Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***
5. ***Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***
6. ***Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.***

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimeve përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për:

6.1 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë;

6.2 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë;

6.3 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë;

6.4 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktet e tjera, të cilat në fakt janë 4 projekt-akte që kanë të bëjnë me emërimin e përkohshëm të këshilltarëve ligjorë që kanë mbaruar

Shkollën e Magjistraturës në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Për më shumë detaje do doja t'ia jepja fjalën zotit Medi Bici.

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me vendimin nr. 424, datë 12.10.2020 miratoi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor.

Një vendimmarrje e tillë u bazua në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (nenet 53, 55 dhe 83), në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (neni 165), si dhe në nenin 6 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Qëllimi i tij është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit, si dhe të pasurisë dhe të figurës (për disa kategori kandidatësh), të kandidatit për kancelar, për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, përfshirë këtu dhe kandidatit për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë.

Ndërkohë që subjektet e këtij vendimi janë listuar në pikën 2, shkronja “a” të Kreut I, dhe konkretisht janë konsideruar si të tillë: i) kandidati për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit; ii) kandidati fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit; iii) kandidati për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit; iv) kancelari në detyrë, këshilltari ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe ndihmësi ligjor në detyrë në gjykatat administrative.

Gjithashtu në dispozitat kalimtare të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të KLGJ-së, titulluar “Dispozita kalimtare dhe të fundit” ndarë në katër seksione, ku në tre seksionet konkretisht A, B dhe C rregullohet mënyra se si do të bëhet verifikimi dhe

emërimi në shërbimin civil gjyqësor: (i) për kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020; (ii) për kandidatët për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, që përfundojnë programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020; (iii) për kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, të pranuar në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Gjithashtu, lidhur me kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, dhe për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, dhe që përfundojnë programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, është parashikuar që deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës, respektivisht të emërohen përkohësisht nga Këshilli si këshilltarë ligjorë pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë dhe emërohen përkohësisht si ndihmës ligjorë mbas krijimit nga Këshilli të Njësive të Shërbimit Ligjor në gjykatat e apelit dhe shpalljes së vendeve të lira.

Duke marrë shkas nga sa më sipër, KLGJ, duhet që këshilltarët ligjorë që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, t'i emërojë përkohësisht pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë Gjykatës së Lartë.

Lidhur me emërimin e përkohshëm të tyre në Gjykatën e Lartë sjellim në vëmendje nenin 34 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon, organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë ku parashikohet ndër të tjera, përbërjen e saj nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar (gjyqtarë), ndërkohë që Këshilltarët ligjorë jomagjistratë emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas kritereve të përcaktuara në këtë dispozitë, si dhe parashikohet se është mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve që miraton rregulla të detajuara për numrin e këshilltarëve ligjorë dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor.

Në një informacion të ardhur nga Gjykata e Lartë (në rrugë elektronike) theksohet se “... deri në miratimin e aktit zyrtar të krijimit të Njesisë së Shërbimit Ligjor, për disa

aspekte të veçanta të punës, këshilltarët ligjorë aktualë po funksionojnë sikur parashikimeve ligjore që lidhen me Njësinë e Shërbimit Ligjor, si p.sh. organizimi dhe ndarja e tyre sipas kolegjeve, ndarja e çështjeve nga drejtuesi i gjykatës duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tyre, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet tyre”. Pra në këtë mënyrë bëhet organizimi i punës së ndihmësve ligjorë deri në funksionimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, në zbatim të nenit 34 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, gjë që bëhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve.

Ndërkohë nëse i referohemi listës së kandidatëve për pranim në shërbimin civil gjyqësor, të cilët kanë përfunduar me sukses formimin fillestar, për vitin akademik 2019-2020, rezulton të jenë në total 4 kandidatë në profilin këshilltarë ligjor. Konkretisht kandidatët janë: Z. {...}; Znj. {...}; Z. {...}; Znj. {...}.

Për të katërt këto kandidatë, bazuar në Vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, të KLGJ, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor”, nga ana e KLGJ-së ka filluar procedura e verifikimit të tyre për pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe janë caktuar relatorët për secilin prej këtyre 4 kandidatëve.

Nga dokumentacioni që disponohet nga drejtoria që mbulon burimet njerëzore, pranë KLGJ-së konstatohet se në organikën e Gjykatës së Lartë lidhur me pozicionin “këshilltar ligjor” ka në dispozicion 32 të tillë, ndërkohë që për pozicionin “ndihmësmagjistrat” ka 4 të tillë.

Aktualisht pranë Gjykatës së Lartë, ka gjithsej 6 ndihmësmagjistratë dhe 5 këshilltarë ligjorë jomagjistratë që përbëjnë organikën efektive të ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë.

Në rastin e supozuar të emërimit të përkohshëm të 4 kandidatëve për Këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë, numri i tyre do të shkonte në 15 këshilltarë, ndërkohë që numri aktual i përcaktuar nga ligji për përbërjen e Gjykatës së Lartë (për gjyqtarët) është 19 anëtarë. Nisur nga numri i madh i dosjeve gjyqësore, numri i përcaktuar nga ligji aktual për përbërjen e Gjykatës së Lartë, që në vlerësimin tonë mund të rritet, si dhe strukturën administrative dhe atë buxhetore të Gjykatës së Lartë, vlerësojmë se është e mundur emërimi i përkohshëm i 4 kandidatëve për këshilltarë ligjorë pranë kësaj gjykate.

Për këtë shkak, Komisioni ka përgatitur edhe 4 projektvendimet që u përkasin kandidatëve {...}, {...}, {...} dhe {...}, të cilët duhet të kalojnë para seancës plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ju faleminderit.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Jemi dakord me projekt-aktet?

Ilir Toska: Do duhet t'i miratojmë një nga një projektvendimet, se janë akte individuale.

Naureda Llagami: Atëherë, po fillojmë me projekt-aktin e parë, i cili ka të bëjë me: 1. Emërimin e përkohshëm të z.{...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, deri në përfundimin e verifikimit të pasurisë dhe figurës. 2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojmë më 01.12.2020. 3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Lartë. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në votim?

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendos Emërimin e përkohshëm të z.{...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e dytë që ka të bëjë me: 1. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, deri në përfundimin e verifikimit të pasurisë dhe figurës. 2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojmë më 01.12.2020. 3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Lartë. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në votim?

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës: 1. Emërimin e përkohshëm të z.{...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, deri në përfundimin e verifikimit të pasurisë dhe figurës. 2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojmë më 01.12.2020. 3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Lartë.

drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Lartë. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në votim?

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të z.{...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me: 1. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, deri në përfundimin e verifikimit të pasurisë dhe figurës. 2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojmë më 01.12.2020. 3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Lartë. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në votim?

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.11.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Projektvendimi “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore në shpenzime operative, të programit 03310 “Buxheti gjyqësor””, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 10:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

7. Projektvendimi “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore në shpenzime operative, të programit 03310 “Buxheti gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore në shpenzime operative, të programit 03310 “Buxheti gjyqësor”. Për më shumë detaje unë do ftoja znj. Luljeta Laze lidhur me relatimin e projekt-aktit.

Luljeta Laze: Faleminderit!

Në vijim të një ndjekjeje dhe monitorim të vazhdueshëm që i është bërë buxhetit, sidomos atij gjyqësor, struktura përgjegjëse mendon që është një moment që ne mund të bëjmë një rishpërndarje të fondeve për shpenzime korrente. Kjo është e lidhur me faktin që, që prej fillimit buxheti i miratuar për vitin 2020 në programin 03310 “Buxheti gjyqësor”, ka qenë më i ulët sesa kërkesa e paraqitur dhe kjo është pasqyruar edhe në detajimin, sikurse ju e dini, që i është bërë fondeve buxhetore për çdo gjykatë.

Nga ana tjetër, gjykatat kanë bërë disa shpenzime shtesë gjatë këtij viti të paparashikuara, për shkak të dezinfektimit që i kanë bërë ambienteve të gjykatës disa

herë për shkak të COVID-it dhe në një analizë të situacioneve të shpenzimeve 10-mujore, disa prej gjykatave kanë kërkuar fonde shtesë për realizimin e disa prej shpenzimeve që janë të nevojës së përditshme të shpenzimeve të 602-shit (shpenzimeve operative).

Meqenëse është vlerësuar se edhe disa gjykata të tjera kanë fonde shtesë dhe pritshmëria edhe për vitin tjetër do jetë që do ketë që jo i gjithë fondi i nevojshëm që ne kemi kërkuara do të realizohet, struktura është e mendimit që të bëjmë të mundur realizimin e një rishpërndarjeje, me qëllim që të mbartim për vitin tjetër sa më pak detyrime të gjykatave.

Fondet që janë kërkuar nga gjykatat janë kryesisht për shpenzime të energjisë elektrike, të zërave avokat, posta gjithashtu u kushton shumë, por specifikisht, sikurse është e paraqitur edhe në tabelën që e mbështet këtë tabelë, Gjykata e Elbasanit ka kërkuar për ekzekutim të vendimeve gjyqësore dhe është një vendim i formës së prerë për marrëdhëniet e punës dhe nuk është vendim i këtij viti (rrjedh që nga viti 2019).

Gjithashtu për t'u theksuar është edhe fakti që Gjykata e Pogradecit nuk e ka në shpenzimet operative, por e ka për sigurimet shoqërore. Sigurisht ndodhin edhe nevoja të tilla në mungesë të llogaritjes me precizion dhe vlera që është kërkuar sigurisht që është edhe e vogël (100 mijë).

Në këtë kuptim, vlerësuar këtë situatë, ne mendojmë që të propozojmë një rishpërndarje të fondeve gjyqësore të programit 03310 "Buxheti gjyqësor" nga ato gjykata që kanë fonde të lira, në gjykatat që kanë sjellë kërkesat për fonde shtesë, sipas tabelave që janë sjellë. Gjykatat që kanë kërkuar fonde dhe që kanë nevojë që t'iu shtohen ato, janë: apeli Korçë me 200 mijë, apeli Vlorë me 300 mijë, rrethi gjyqësor Durrës me 300 mijë, rrethi gjyqësor Elbasan me 2 milion, rrethi gjyqësor Pogradec me 100 mijë (në sigurime) dhe rrethi gjyqësor Vlorë me 1 milion e 600 mijë (602). Ndërsa gjykatat që janë listuar se kanë fonde të lira në këtë moment, (që theksoj që u është marrë konfirmimi për këtë gjë) janë: apeli Shkodër me 1 milion, rrethi gjyqësor Dibër me 500 mijë, rrethi gjyqësor Fier me 1 milion, rrethi gjyqësor Mat me 400 mijë, administrative e shkallës së parë Tiranë me 500 mijë dhe nga fondi që kemi mbajtur për buxhetin e gjykatave në KLGJ, fonde të lira kemi 1 milion. Ky fond është përdorur, sikurse e dimë, sa herë që kemi bërë emërimet përkatëse, qoftë të magjistratëve, qoftë edhe për emërimet

e reja që janë bërë nga numri shtesë që jepet nga ligji i buxhetit. Prandaj kemi vendosur të përdoret edhe një pjesë e këtij buxheti që ka mbetur pa përdorur. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore 1. “Shpenzime Operative”, brenda programit “Buxheti Gjyqësor” të shumës prej 4,400,000 lekë, sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore “Shpenzime kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, të shumës prej 100,000 lekë brenda programit “Buxheti Gjyqësor”, sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Me kaq mbyllet këto projekt-akte.

Takohemi në orën 12:00.

Dëshiroj t'ju informoj që nga ana e magjistratit na është bërë me dije që e ka të pamundur që të jetë prezent sot në seancë dëgjimore për shkak të infektimit të tij me COVID. Gjithsesi, për efekt të seancës, ne do ta zhvillojmë për të lënë një datë tjetër, pasi të vlerësohet nga ana e Këshillit. Shihemi në orën 12:00 tek salla e madhe.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë në sallë)

(Mbajtur, më 12.11.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.11.2020).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 12:06.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 7. Përfaqësues të ILD-së.**

RENDI I DITËS:

8. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.11.2020).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Fillojmë zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Siç jeni në dijeni, kjo seancë vijon nga mbledhja plenare e datës 5 nëntor 2020.

Magjistrati nën procedim z. {...} nuk u paraqit në seancën e datës 5 nëntor duke njoftuar me e-mail Këshillin dhe mosparaqitja e tij vjen për shkak se bashkëshortja dhe njëkohësisht përfaqësuesja e tij ligjore në këtë procedim, dyshohet për simptomat e COVID-19, për të cilën ka bërë edhe analizë mjekësore përkatëse dhe pret rezultatin.

Po çelim vazhdimin e seancës dëgjimore.

Verifikohet prezenca.

Nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është paraqitur vet zoti Inspektor i Përgjithshëm.

Artur Metani: Dhe Periand Teta, Këshilltar Kabineti.

Naureda Llagami: Ndërkohë që nga ana e magjistratit, dëshirojmë që t'ju bëjmë me dije që magjistrati na ka njoftuar përmes e-mailit, ditën e sotshme, në orën 10:00, ku na ka njoftuar që prej datës 10 nëntor 2020, sipas rregullit ndodhet i karantinuar familjarisht, pasi janë vërtetuar prezencën e virusit COVID-19 në familje. Për këtë arsye ai kërkon që të bëhet shtyrje e seancës sepse nuk mundëson që në këto momente të jetë prezent në këtë seancë dhe sugjeron për një kohë të papërcaktuar mospjesëmarrjen e tij.

Artur Metani: Pra është i sëmurë vet ai apo është i sëmurë dikush në familje?

Naureda Llagami: Nga dokumentacioni që na ka bashkëlidhur rezulton që është pozitive bashkëshortja dhe përfaqësuesja e tij ligjore, ndërkohë që vet magjistrati thotë që si familje, duke qenë se janë në këtë situatë, janë të karantinuar (duke qenë se pjesëtarë të familjes janë me COVID).

Artur Metani: Atëherë, për sa më takon mua, pa dyshim jam dakord që të shtyhet seanca sepse edhe në bazë të urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë, afati i karantinimit është një afat 2-javor, për shkaqe që janë të parashikuara dhe familja është e një nga shkaqet e parashikuara. Kështu që nëse Këshilli do vlerësonte që ta zgjaste, unë jam dakord. Për afatin pastaj është një gjë që...

Naureda Llagami: Keni ndonjë propozim?

Artur Metani: Afati i karantinimit është 2 javë apo 14 ditë.

Pra në bazë të këtij afati sipas urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë, të vendoset edhe data e seancës tjetër.

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli po vlerëson për afatin.

Nga ana e Këshillit, mendohet data 3 dhjetor 2020, ora 12:00, në qoftë se për ju...

Artur Metani: Jo! –mendoj që është vonë.

2-javëshi fillon nga momenti i shfaqjes së simptomave, jo nga momenti i mbledhjes. Kështu që nëse simptomat janë shfaqur, po themi më datë 10 nëntor, atëherë 2-javëshi i bie më datë 24-25 nëntor.

Naureda Llagami: Rezultati është 09.11.

Artur Metani: Pa dyshim të shërohet, por ai nuk është i sëmurë. Është bashkëshortja.

Më fal, edhe një sugjerim tjetër.

Duhet parë edhe mundësia e organizimit të seancës “online”, meqenëse ai nuk është i sëmurë, që do të thotë është në gjendje për ta bërë seancën, por për shkak karantinimi ai nuk mund të dalë nga shtëpia, duhet vlerësuar edhe mundësia e bërjes së seancës “online”, nëse magjistrati do ishte në gjendje, do kishte mundësi teknike.

Naureda Llagami: Atëherë, ta lëmë më datë 26 nëntor, ora 11:00.

Nëse magjistrati nuk paraqitet, atëherë do i propozojmë edhe mundësinë që të zhvillojmë seancën dëgjimore “online”. Dakord?

Me kaq po e mbyllim seancën dëgjimore. Faleminderit!

(Dalin nga salla e mbledhjes z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe z. Periand Teta, Këshilltar Kabineti pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë në sallë)

(Mbajtur, më 12.11.2020)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 12:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Medi Bici** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ilir Toska** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 7. Përfaqësues të ILD-së.**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Çështja e fundit e rendit të ditës relatohet nga zonja Naureda Llagami.

Shkurtimisht relatohet relacioni shpjegues lidhur me miratimin e listës së gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

“Në zbatim të Ligj nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenin 221 pika “3”, ku parashikohet, jo më vonë se data 15 nëntor e çdo viti kalendarik, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikon dhe i dërgon listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në Kuvendin e Shqipërisë dhe tek Presidenti i Republikës, janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

Sipas pikës 1 të nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në shortin e përzgjedhjes së anëtarëve të KED janë:

a) në kohën e hedhjes së shortit magjistrati që ushtron detyrën pranë gjykatave administrative, gjykatave të apelit, ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 10 vjet; b) nuk ka një masë disiplinore në fuqi; c) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit; ç) magjistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit

etike dhe profesionale, nëse janë të disponueshme; d) magjistrati nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; dh) magjistrati nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.

Nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, është përgatitur një draft - listë me magjistratët e Gjykatave të Apeleve dhe Gjykatave Administrative të cilët plotësojnë kriterin e 10 vjetëve në ushtrimin e detyrës, që nuk kanë masa disiplinore në fuqi dhe që janë vlerësuar të paktën shumë mirë në 2 vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, nëse janë të disponueshme.

Gjithashtu u plotësuar dhe një draft- listë tjetër, me magjistratët që nuk plotësonin kriterin e vjetërsisë në detyrë, të cilët:

a) nuk kanë 2 vlerësime shumë mirë

b) magjistratë të shkarkuar nga KPK , të cilët janë të pezulluar për shkak të ligjit nr.84/2016, neni 62, pika 1.

c) magjistratët që janë të pezulluar, për shkak të një hetimi, ose të dënuar me vendim gjykate.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Shërbimeve Juridike u hartuan shkresat për të kërkuar informacion në institucionet Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD), Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) si dhe Prokurorinë e Përgjithshme, në lidhje me pikat “c” “d” “dh” të nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, konkretisht nëse plotësojnë kushtet:

c) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;

d) magjistrati nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) magjistrati nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.

Me shkresën nr. 5701, datë 06.11.2020 ju kërkuar informacion Prokurorisë së Posaçme, kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar(SPAK), e cila me në shkresën nr.7435/1, datë 10.11.2020 citon se: ...nuk rezulton që janë të regjistruar si persona në

hetim gjyqtarët e mëposhtëm..., ndërkohë një çështje e regjistruar ndaj gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}, me vendimin nr.5, datë 26.10.2020 është vendosur pushimi i çështjes (bashkëlidhur shkresa e përgjigjes dhe vendimi).

Me shkresën nr.5689, datë 05.11.2020, ju kërkua informacion Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili me shkresën nr.2571/1 datë 06.11.2020, njofton mbi fillimin e procedimit disiplinor për dy magjistratë:

1. Z.{...}, ish-gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë (Shkarkuar me vendimin nr. 529, datë 27.10.2020 të KLGJ);

2. Z.{...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (bashkëlidhur shkresa e përgjigjes).

Me shkresën nr. 5709, datë 06.11.2020 është kërkuar informacion Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili, me shkresën nr.2996/1 datë 09.11.2020, informon, se nuk ka as një gjyqtar për të cilin të jenë vendosur sanksione administrative ose të jetë kallëzuar penalisht (bashkëlidhur shkresa e përgjigjes).

Me shkresën nr.5690, datë 05.11.2020 është kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme, e cila në kthim përgjigjet nr. 5690/2 prot, datë 10.11.2020, dërgoi përgjigjet e marra nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Nga informacioni i përcjellë rezultoi si më poshtë

Për rastin e znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Administrative, morëm informacion në vazhdim nga prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë (e-mail bashkëlidhur), se: është regjistruar procedim penal me nr. 5736, viti 2019 ... pa emër të regjistruar me qëllim për të grumbulluar të dhëna të nevojshme lidhur me përcaktimin e faktit të veprës penale.

Për rastin e znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Administrative, morëm informacion në vazhdim nga prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë (e-mail bashkëlidhur), se: është regjistruar procedim penal me nr. 5736, viti 2019 ... pa emër të regjistruar me qëllim për të grumbulluar të dhëna të nevojshme lidhur me përcaktimin e faktit të veprës penale.

Për rastin e znj. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, Tiranë, morëm informacion në vazhdim nga prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë (e-mail

bashkëlidhur), se: është regjistruar procedim penal me nr. 5736, viti 2019 ... pa emër të regjistruar me qëllim për të grumbulluar të dhëna të nevojshme lidhur me përcaktimin e faktit të veprës penale.

Për rastin e znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, Tiranë, morëm informacion në vazhdim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan (e-mail bashkëlidhur), se: është regjistruar procedim penal me nr. 974, viti 2019 ... nga verifikimi në regjistrat fizikë dhe elektronikë për këtë procedim rezulton se nuk është regjistruar emri i saj si person nën hetim.

Për rastin e z. {...}, gjyqtar në gjykatën e Apelit Vlorë, morëm informacion në vazhdim nga prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier (e-mail bashkëlidhur), se: kallëzimi penal me nr. 1544, datë 02.11.2020 është në faze verifikimi, nuk është regjistruar ende procedimi penal dhe në kolonën përkatëse nuk është regjistruar asnjë emër të cilit i atribuohet vepra penale.

Për rastin e z. {...}, gjyqtare në gjykatën e Apelit Vlorë, morëm informacion në vazhdim nga prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier (e-mail bashkëlidhur), se: kallëzimi penal me nr. 1544, datë 02.11.2020 është në faze verifikimi, nuk është regjistruar ende procedimi penal dhe në kolonën përkatëse nuk është regjistruar asnjë emër të cilit i atribuohet vepra penale. Ndërkohë për kallëzimin nr.1348, datë 25.09.2020, i është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë. Në përgjigjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë (e-mail bashkëlidhur) cilësohet se nuk ka të regjistruar me këtë emër në regjistrin e veprave penale si person i dyshuar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për z. {...} shprehet se "është dërguar kallëzimi penal për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, datë 15.05.2020. Në përgjigjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, citohet se nuk rezulton të ketë asnjë procedim penal të regjistruar për subjektet e listës emërore.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për znj. {...}, shprehet se procedimi penal nr. 99, datë 22.01.2018, është transferuar, për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Në përgjigjen e Prokurorisë pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, citohet se nuk rezulton të jetë apo të ketë qenë asnjë gjyqtar nën hetim nga lista emërore e dërguar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për znj. {...}, shprehet se procedimi penal nr. 770, datë 29.10.2007, është transferuar për kompetence në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë. Në përgjigjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, citohet se nuk rezulton te jete apo te ketë qenë asnjë gjyqtar nën hetim nga listës emërore e dërguar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për z.{...}, shprehet se procedimi penal nr.9270, viti 2019, është transferuar për kompetence në Prokurorinë Posaçme. Në përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme, citohet se nuk rezulton te jete apo të ketë qenë asnjë gjyqtar nen hetim nga listës emërore e dërguar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për znj. {...}, shprehet se procedimi penal nr. 7446, viti 2019, është transferuar për kompetence në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Në përgjigjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, citohet se nuk rezulton të jetë apo të ketë qenë asnjë gjyqtar nën hetim nga lista emërore e dërguar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për znj. {...} (gjykojmë i referohen {...}), shprehet se procedimi penal nr. 7450, viti 2019, është transferuar për kompetence në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Në përgjigjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, citohet se nuk rezulton të jetë apo të ketë qenë asnjë gjyqtar nën hetim nga lista emërore e dërguar.

Në bazë dhe të përgjigjeve të marra nga institucionet përkatëse, bashkëlidhur gjeni draft- listën e magjistratëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në shortin për anëtar KED dhe draft - listën e magjistratëve që nuk plotësojnë kriteret.

Nisur nga sa më sipër është përgatitur projektvendimi me titull “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidat për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2021”.

Në pikën 1 të këtij vendimin përcaktohet miratimi i listës së gjyqtarëve kandidat për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”. Ndërkohë në pikën 2 të projektvendimit, duke marrë shkak nga detyrimi që përcaktohet në ligj, konkretisht në pikën 4, neni 221 i ligjit nr.115/2016, i ndryshuar, është përcaktuar që listat e kandidatëve

që i plotësojnë kushtet dhe lista e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në shortin për anëtarë të KED, bëhet publike në faqen zyrtare të institucionit.

Gjithashtu edhe në pikën 3 të projektvendimit është përcaktuar, që kandidatët të cilët nuk janë përfshirë në listën e miratuar të njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar lidhur me shkaqet e përjashtimit. Në aktin e njoftimit secilit prej tyre t'i bëhet me dije e drejta për ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në pikën 4 të projektvendimit është parashikuar që Lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pranë Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Në fund është parashikuar hyrja në fuqi e këtij vendimi me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Ndërkohë anëtarët e Këshillit janë njohur edhe me projektvendimin i cili shoqëron relacionin e cituar më sipër, konkretisht:

“1. Miratimin e listës së gjyqtarëve të cilët mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2021, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Lista me gjyqtarët kandidatë të miratuar në pikën 1 të këtij vendimi si dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet në faqen zyrtare të institucionit.

3. Kandidatët të cilët nuk janë përfshirë në listën e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar lidhur me shkaqet e përjashtimit. Në aktin e njoftimit secilit prej tyre t'i bëhet me dije e drejta për ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Ngarkohet Kryetarja e Këshillit për të përcjellë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pranë Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këtë propozim të ardhur në mbledhjen plenare “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor